

LIGJI PER NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË LIGJIT PËR MATERIALIN ARKIVOR

Gazeta zyrtare në R. Maqedonisë nr. 41 nga 27.02.2014

Neni 1

Në Ligjin për materialin arkivor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 95/12), pas nenit 1 shtohet neni i ri 1-a, i cili thotë:

"Neni 1-a

Arkivi Shtetëror drejtohet nga një drejtor.

Drejtori i Arkivit shtetëror emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Për emërimin e drejtorit publikohet shpallje publike në tri gazeta ditore të cilat janë të lëshuara në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, njëra prej të cilave gazetë që botohen në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin një gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Për drejtor mund të emërohet personi që i plotëson kushtet e mëposhtme:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës nuk është i dënuar me gjobë ose sanksion kundërvajtës, ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) të ketë fituar së paku 240 kredi ECTS ose të ketë mbaruar shkallën VII/1;
- 4) ka minimum 5 vjet përvoj pune;
- 5) zotëron një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatat për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT të paktën 74 pikë;
 - IELTS (IELTS) të paktën 6 pikë;
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - të paktën nivelin B2;
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të kaluar;
 - BULATS (BULATS) - të paktën 60 pikë
 - APTIS (APTIS) - të paktën nivelin B2;
 - të paktën nivelin B2 dhe 6, ka të kaluar testin psikologjik dhe testin për intekritet."

Neni 2

Në nenin 61, paragrafi 2 ndryshohet dhe thuhet:

"Pas ankimimit të vendimit të inspektorit vendos Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurën administrative dhe procedurën për marrëdhënie pune të shkallës së dytë."

Paragrafi 3 fshihet.

Neni 3

Drejtori i Arkivit i shtetëror emërohet deri në ditën e fillimit të zbatimi i nenit 1 të këtij ligji vazhdon të kryejë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 4

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të dispozitave që i referohen kushtit për njohjen e një gjuhe të huaj që do të fillojë të zbatohen pas dy vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës s Maqedonisë”.